



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES
AGJENCIA E INDUSTRIË SË MBROJTJES

Nr. 429 prot.

Tiranë, më 24.07.2026

URDHËR

Nr. 151 datë 24.07.2026

PËR
MIRATIMIN E RREGULLAVE DHE PROCEDURAVE PËR VLERËSIMIN DHE
LEJIMIN E NËNKONTRAKTIMIT

Në mbështetje të nenit 6, shkronjat "a" të VKM-së nr. 794, datë 19.12.2024, "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Industrisë së Mbrojtjes" dhe nenit 6, pika 3, shkronja "a" të Rregullores së Brendshme të Agjencisë së Industrisë së Mbrojtjes, miratuar me Urdhrin nr. 2514, datë 02.12.2025, të Ministrit të Mbrojtjes me qëllim miratimin e rregullave dhe procedurave për vlerësimin dhe lejimin e nënkontraktimit,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullave dhe procedurave për vlerësimin dhe lejimin e nënkontraktimit, dhe lidhjes përkatëse, sipas teksit që i bashkëlidhet këtij urdhëri dhe është pjesë e pandarë e tij.
2. Me këto rregulla njihet i gjithë personeli i Agjencisë së Industrisë së Mbrojtjes dhe subjektet e licencuara.
3. Ndjek zbatimin e këtij urdhëri Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, Drejtoria e Ekspertizës Teknike, Drejtoria e Analizës, Planifikimit dhe Bashkëpunimit, Drejtoria e Inspektimit dhe Standarteve si dhe Drejtoria e Vlerësimit të Lehtësirave.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM



Adresa: Rruga e "Dibrës", Tiranë, Kutia Postare 2423

Telefon centrali: (04)2226601

Faqe 1 nga 1



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBOJTJES
AGJENCIA E INDUSTRIË SË MBROJTJES

RREGULLAT DHE PROCEDURAT PËR VLERËSIMIN DHE LEJIMIN E
NËNKONTRAKTIMIT

(Miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Industrisë së Mbrojtjes
nr. 15 datë 24.07 2026)

Tiranë më 24.07 .2026

1. Hyrje

- 1.1 Rregullat dhe procedurat për vlerësimin dhe lejimin e nënkontraktimit nxirren në zbatim të Nenit 28 të Ligjit nr. 87/2024, *"Për rregullimin e prodhimit, tregtimit, kërkimit dhe zhvillimit të armëve, municioneve, pajisjeve dhe teknologjive ushtarake"*, dhe në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 793, datë 19.12.2024, *"Për licencat dhe autorizimet e lëshuara nga Agjencia e Industrisë së Mbrojtjes* me qëllim përcaktimin e kushteve, kriterëve, procedurave dhe kufizimeve për vlerësimin dhe miratimin e nënkontraktimit të një pjese të aktivitetit të operatorëve ekonomikë të licencuar në veprimtarinë e prodhimit të armatimit ushtarak.
- 1.2 Nënkontraktimi nënkupton transferimin e kryerjes së një procesi prodhimi të identifikueshëm, i lidhur drejtpërdrejtë me prodhimin e armatimit ushtarak.
- 1.3 Blerja e materialeve, lëndëve të para, komponentëve standarde ose shërbimeve administrative nuk përbëjnë nënkontraktim në kuptimin e këtyre rregullave.
- 1.4 Nënkontraktimi nuk nënkupton transferim të licencës dhe nuk i jep operatorit ekonomik të nënkontraktuar të drejtën për të ushtruar në mënyrë të pavarur veprimtari të prodhimit të mallrave ushtarake.
- 1.5 Subjekti i licencuar që nënkontraktin një pjesë të aktivitetit të prodhimit ka përgjegjësisë të plotë për përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga licenca për kryerjen e aktivitetit të prodhimit.

2. Procedura

- 2.1 Operatori ekonomik i licencuar në veprimtarinë e prodhimit të armatimit ushtarak, i cili ka nevojë për të nënkontraktuar një pjesë të aktivitetit për të cilin është licencuar, për arsye teknike, profesionale ose të tjera që lidhen me procesin e prodhimit, paraqet pranë AIM një kërkesë të arsyetuar për lejimin e nënkontraktimit.
- 2.2 Kërkesën për lejimin e nënkontraktimit shoqërohet me dokumentacionin e më poshtëm:
 - a) formularin e aplikimit;
 - b) arsyetimin dhe aktivitetin që kërkohet të nënkontraktohet;
 - c) të dhënat e plota të operatorit ekonomik të propozuar si nënkontraktor;
 - d) përshkrimin e saktë të detyrave që do të kryhet nga nënkontraktori;
 - e) kopje të draft-marrëveshjes së nënkontraktimit;
 - f) ekstrakt i Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) ose regjistrit tregtar të operatorit ekonomik i cili do të nënkontraktohet;
 - g) vërtetim nga organet tatimore dhe doganore se nuk ka detyrime të pashlyera për operatorin ekonomik i cili do të nënkontraktohet;
 - h) dëshmi penaliteti për administratorët dhe/ose personat e autorizuar të subjektit;

- 2.3 Për nënkontraktorët me seli jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, dokumentacioni i mësipërm paraqitet i shoqëruar me përkthim zyrtar të noterizuar në gjuhën shqipe, sipas legjislacionit në fuqi.
- 2.4 Kur nënkontraktori është operator ekonomik i pajisur me licencë të vlefshme prodhimi nga AIM për aktivitetin që kërkohet të nënkontraktohet, AIM njoftohet sipas pikës 2.1 Në këtë rast dokumentacioni i kërkuar sipas pikës 2.2 reduktohet në kopjen e licencës në fuqi të nënkontraktorit dhe dokumentet e kërkuara në nënpikat a-e.
- 2.5 Draft marrëveshja e nënkontraktimit nënshkruhet dhe hyn në fuqi vetëm pas lejimit të nënkontraktimit nga AIM.
- 2.6 Brenda 20 (njëzet) ditëve nga dita e paraqitjes së kërkesës sipas pikës 17 të kreut VII të Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 793, date 19.12.2024 “*Për Licencat dhe Autorizimet e Lëshuara nga Agjencia e Industrisë së Mbrojtjes*”, AIM shqyrton kërkesën e paraqitur dhe kryen verifikime mbi përmbushjen e kriterëve të sigurisë dhe kërkesave të tjera të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
- 2.7 Kur nënkontraktori i propozuar është person juridik i huaj ose kur aktiviteti i nënkontraktuar do të kryhet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, zbatohen dispozitat e kësaj rregulloreje me ndryshimet e mëposhtme:
- a) AIM kryen një procedurë verifikimi specifike, që mund të përfshijë konsultimin me autoritetet kompetente të vendit të origjinës së nënkontraktorit ose me strukturat homologe ndërkombëtare;
 - b) AIM mund të kërkojë dokumentacion shtesë sipas legjislacionit për transferimet ndërkombëtare.
- 2.8 Në përfundim të verifikimit AIM lejon ose refuzon nënkontraktimin.

3. Detyrimet e subjektit të licencuar

- 3.1 Subjekti i licencuar në veprimtarinë e prodhimit të armatimit ushtarak ka këto detyrime në lidhje me nënkontraktimin e një pjese të aktivitetit:
- a) të garantojë që subjekti i nënkontraktuar plotëson kriteret profesionale, teknike, financiare dhe ligjore të përcaktuara në legjislacionin në fuqi;
 - b) të sigurojë që nënkontraktori respekton standardet teknike, afatet kontraktuale dhe kërkesat e sigurisë të përcaktuara në legjislacionin në fuqi;
 - c) të mbikëqyrë procesin e prodhimit të kryer nga nënkontraktori, përfshirë kontrollin teknik, gjurmueshmërinë e proceseve të prodhimit dhe përputhshmërinë e tyre sipas kushteve të licencës;
 - d) të mbajë përgjegjësi të plotë për përmbushjen e të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga licenca dhe legjislacioni në fuqi.
 - e) Nënkontraktori i autorizuar nuk mund t’ia kalojë realizimin e detyrave të autorizuara subjekteve të tjera të treta (nënkontraktim i mëtejshëm) pa autorizim të ri të AIM.

4. Moslejimi i nënkontraktimit:

- 4.1 Nënkontraktimi nuk lejohet për proceset kritike të prodhimit të mallrave ushtarake, përfshirë montimin përfundimtar të mallit ushtarak, integrimin përfundimtar të sistemeve që lidhen me softet dhe pajisjet teknologjike me funksion të drejtëpërdrejtë luftarak, testimin përfundimtar dhe certifikimin e produktit ushtarak. Këto procese kryhen ekskluzivisht nga operatori ekonomik i pajisur me licencë për prodhimin e armatimit ushtarak dhe nuk mund të transferohen tek subjektet e nënkontraktuara.

5. Sanksionet

- 5.1 Mosrespektimi i detyrimeve të parashikuara nga Neni 28 i Ligjit nr. 87/2024 trajtohet sipas Nenit 33 të të njëjtit ligj.

6. Rishikimi dhe përditësimi

- 6.1 Këto rregulla rishikohen dhe përditësohen në rastet kur:
- a) eksperiencia operative evidenton nevojën për përshtatje të procedurave;
 - b) rekomandohen ndryshime nga auditime ndërkombëtare ose nga Ministria e Mbrojtjes;
 - c) ndryshon legjislacioni në fuqi që rregullon veprimtarinë e prodhimit të armatimit ushtarak.

7. Hyrja në fuqi

- 7.1 Këto rregulla hyjnë në fuqi menjëherë pas miratimit me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Industrisë së Mbrojtjes dhe janë të detyrueshme për të gjithë operatorët ekonomikë të licencuar në veprimtarinë e prodhimit të armatimit ushtarak.